

V E N D I M
Nr. 507, datë 16.10.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, E CILA
PREKET NGA NDËRTIMI I DEPOS SË UJIT TË PIJSHËM NË BASHKINË E GRAMSHIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit Dylber Ali Mema, që preket nga ndërtimi i depos së ujit të pijshëm në bashkinë e Gramshit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Gramshit.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2 255 m² truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 728 550 (dy milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Investime dhe shpronësime", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 89 000 (tetëdhjetë e nëntë mijë) lekësh, në ngarkim të bashkisë së Gramshit, kërkuesit për shpronësim.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1 nëntor dhe të përfundojë brenda datës 15 nëntor 2002.
 7. Punimet për ndërtimin e depos së ujit të pijshëm në qytetin e Gramshit të fillojnë më 15.11.2002 dhe të përfundojnë më 30.11.2003.
 8. Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga bashkia e Gramshit.
 9. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, prefektura e qarkut të Elbasanit dhe bashkia e Gramshit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA EMËRORE E PERSONIT QË DO TË SHPRONËSOHET PËR NDËRTIMIN E DEPOS SË
UJIT TË PIJSHËM NË BASHKINË E GRAMSHIT**

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi Lek/m ²	Vlera në lekë
1	Dylber Ali Mema	2 255	1 210	2 728 550
	Shuma	2 255	1 210	2 728 550